Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit për shkeljen e rregullave ligjore në procesin zgjedhor të dorëzuar nga parashtrues i njohur, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e57-të, të mbajtur më 17.12.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-4032 nga viti 2021 e formuar pas pretendimeve për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor, NDËRPRITET .

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, , KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm sepse në rastin në fjalë ndërsa me kërkese të KSHPK-së ka vepruar organ tjetër kompetent dhe ka konstatuar se pretendimet t nuk u konfirmuan.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4032 nga viti 2021, e formuar pas denoncimit me numër 12-4032 / 1 nga 20.10.2021, e dorëzuar në KSHPK nga parashtruesi i njohur ---------- ---- --- ------ ----------- - ", me pretendime për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor - Zgjedhjet lokale 2021. Përndryshe, në denoncim ja nxjerr pretendime kundër drejtorit të -------------------, për shkak të lidhjes së kontratave të punës dhe punësimit të disa punëtorëve me kohë të caktuar gjatë fushatës zgjedhore të filluar zyrtarisht, që sipas parashtruesit të denoncimit është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Për verifikimin e pretendimeve dhe konstatimin e gjendjes faktike të rastit të lëndës, KSHPK-ja i ka paraqitur kërkesë Inspektoratit Shtetëror të Punës për të vepruar në kuadër të kompetencave ligjore dhe për të kryer një inspektim të jashtëzakonshëm në institucionin në fjalë lidhur me ligjshmërinë e procedurave kontraktuese për punë dhe punësim të personave të caktuar me kohë të caktuar që janë realizuar/zbatuar gjatë procesit zgjedhor 2021. Pas kërkesës së KSHPK-së është vepruar janë pranuar informacione me dokumentacion të bashkangjitur dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit të marrë është konstatuar:

Për rastin e denoncuar është bërë kontroll i jashtëzakonshëm dhe është përgatitur procesverbal në të cilin nga mbikëqyrja në vendngjarje në ------------------ me raport të inspektorit shtetëror të punës është konstatuar se:

- Tek punëdhënësi me marrëdhënie pune të vendosur në pajtim me ligjin janë punësuar gjithsej 156 persona, ndërsa me kontratë për periudhën nga 01.04.2021 deri më 31.10.2021 dhe nga 01.05.2021 deri më 31.10.2021 janë punësuar 9 persona. 01.08 .2021 deri më 31.10.2021 dhe nga 05.08.2021 deri më 31.10.2021.
- Në periudhën prej datës 06.08.2021 – kur janë shpallur zgjedhjet lokale 2021 – është konstatuar se institucioni në fjalë si punëdhënës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me procedurat për lidhjen e kontratave për punësim dhe punësimin e personave të caktuar në orar të caktuar të punës. , dmth. për këtë periudhë nuk ka pasur punësime për çfarë do baze.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se lidhur me pretendimet e denoncuara, me kërkesë të KSHPK-së, ka vepruar organi tjetër kompetent dhe me inspektimin e jashtëzakonshëm të kryer, pretendimet nuk janë vërtetuar për çka KSHPK ka vendosur si në dispozitë të këtij Vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi

Punoi: J.C.
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së